



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
KRYETARI

Nr. 9703 Prot

Vlorë, 08.11.2019

URDHËR I BRENDSHËM
Nr. 250, datë 08.11 2019

"PËR
MIRATIMIN E KARTËS SË AUDITIMIT NË NJËSINË E AUDITIMIT TË
BRENDSHËM"

Bazuar në Ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 8 pika 2, neni 9, pika 1.1.b të Kreut III, nenin 64 të Kreut X, Ligjin nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", neni 12 gërma c, Urdhërin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.100, datë 26.10.2016 "Miratimi i Manualit të Auditimit të Brendshëm " pika 2.5 Kap II,

URDHËROJ:

1. Të miratohet Karta e Auditimit në Njësinë e Auditimit të Brendshëm.
2. Një kopje e këtij urdhëri i dërgohet Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.
3. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Njësia e Auditimit të Brendshëm.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Dritan Leli





**REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA VLORE
NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM**

**KARTA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM
PËR
BASHKINË VLORE**

PËRMBLEDHJE :

1. Hyrje
2. Qëllimi dhe përmbajtja e Kartes së Auditimit të Brendshëm,
3. Statusi Organizativ,
4. Misioni dhe Fushëveprimi i punës,
5. Qëllimi ,
6. Objekti i punës,
7. Përgjegjshmeria,
8. Pavarësia dhe Objektiviteti,
9. Përgjegjësitë e aktorëve,
10. Autoriteti,
11. Integriteti,
12. Kufizimet,
13. Shërbimet e sigurisë dhe shërbimet e këshillimit (konsulencës),
14. Statusi i auditimit të brendshëm në Bashkinë Vlorë
15. Programi i sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë
16. Standardet dhe Kuadri i Praktikave Profesionale;
17. Hyrja ne fuqi e Kartës së Auditimit.

1. HYRJE

Hartimi i Kartës së Auditimit të Brendshëm është domosdoshmëri e parashikuar nga Standardet Ndërkombetare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm, të hartuara dhe të shpallura nga organizata profesionale ndërkombetare, Instituti i Audituesve të Brendshëm (IIA) në SHBA, në ligjin e Auditimit të Brendshëm dhe në Metodologjinë për kryerjen e shërbimit të auditimit.

2. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E KARTËS SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Karta e Auditimit të Brendshëm është dokumenti që përshkruan misionin, qëllimin, objektivat e punës, autoritetin dhe përgjegjësinë e funksionimit të auditimit të brendshëm të përcaktuara në standardet ndërkombetare për praktikën profesionale të kësaj veprimtarie dhe metodologjinë e auditimit të brendshëm, si dhe rregullat që drejtojnë veprimtarinë e tij. Karta formalizon dhe pozicionon funksionin e auditimit të brendshëm si njësi brenda Bashkisë Vlorë dhe specifikon qëllimin e aktiviteteve të auditimit të brendshëm. Ky dokument cakton fushat e ushtrimit të përgjegjësisë profesionale, natyrën, rolin e mandatin, si dhe identifikon standardet sipas të cilave ky shërbim do të zbatohet.

Në respektim të kërkesës të përcaktuar në pikën 2.5 “Karta e auditimit të brendshëm” të Kapitullit të II-të të Manualit të Auditimit të Brendshëm, çdo njësi e Auditimit të Brendshëm duhet të ketë Kartën e saj të Auditimit të Brendshëm.

Hartimi i saj është bazuar në :

- Standardet Ndërkombetare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm, të hartuara dhe të shpallura nga organizata profesionale ndërkombetare, Instituti i Audituesve të Brendshëm (IIA) në SHBA,
- Ligjin nr 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”,
- Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdherin nr 100, datë 25.10.2016 të Ministrisë të Financave “Për Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”.

Karta e Auditimit të Brendshëm përfaqëson një ndër dokumentet kryesore të Njesisë së Auditimit të Brendshëm.

3. STATUSI ORGANIZATIV

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) është pjesë përbërëse e strukturës organizative të Bashkisë Vlorë e pavarur nga ana organizative dhe kurdoherë jashtë strukturave operative.

Struktura dhe organizimi i NJAB miratohet me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë, si pjesë përbërëse e strukturës së institucionit. Kjo njësi ka varesi funksionale nga Kryetari i Bashkisë Z. Dritan Leli

4. MISIONI DHE FUSHËVEPRIMI I PUNËS

Ligji mbi auditimin e brendshëm, prezanton përkufizimin e “auditimit të brendshëm”

Neni 2– Ligji mbi auditimin e brendshëm

Auditimi i Brendshëm është një veprimtari e pavarur që i jep siguri objektive dhe i ofron këshillim për menaxhimin e projektuar për të shtuar vlerën e për të përmirësuar veprimtarinë e njësisë publike. Auditimi i brendshëm ndihmon njësinë publike për të arritur objektivat, nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike, për të vlerësuar e përmirësuar frytshmerinë e menaxhimit të riskut, si dhe proceset e kontrollit e të qeverisjes.

Misioni i NJAB është:

- Të ofrojë shërbime të pavarura, objektive, siguruese dhe këshilldhënëse të dizenuara që të shtojnë vlerën dhe përmirësojnë operacionet e bashkisë;
- Ushtrimi i një metode të integruar dhe të disiplinuar për vlerësimin dhe përmirësimin e proceseve të qeverisjes, administrimin e rrezikut dhe kontrolleve të brendshme pranë bashkisë si njësi publike;
- Të ndihmojë bashkinë për të përmbushur objektivat e veta duke ofruar një trajtim sistematik dhe të disiplinuar, për të vlerësuar dhe përmirësuar efektivitetin e proceseve të menaxhimit të riskut, kontrollit dhe qeverisjes;
- Të shtojë vlerën e veprimeve të subjekteve brenda fushës së përgjegjësisë dhe të kontribuojë në ndërtimin dhe përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, të forta e të besueshme, që garantojnë mbrojtjen e pasurisë publike, duke siguruar cilësi me kosto të reduktuara;
- Të japë siguri të arsyeshme për kryetarin e bashkisë në mënyrë të pavarur dhe objektive;
- Të ofrojë shërbime këshillimi, për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në Bashkinë Vlorë
- Të sjellë përfitime në efikasitetin operacionale, kontrolle të brendshme të forta dhe politika të përmirësuara.
- Për të realizuar këtë mision, auditimi i brendshëm bazohet mbi një strategji të vlerësimit të rrishtit duke kryer auditime dhe paraqet raporte të pavarura për efektivitetin e kontrolleve të menaxhimit dhe performancën operacionale të subjektit të audituar.

Fushëveprimi i punës së AB është që të përcaktoj nëse proceset e menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes të hartuara dhe paraqitura nga menaxhimi, janë adekuate dhe funksionon në atë mënyrë saqë garanton se:

- Rreziqet identifikohen dhe menaxhohen në mënyrën e duhur;
- Ndërveprimi me grupet e ndryshme të qeverisjes ndodhë sipas nevojës dhe me efektivitet;
- Informacioni financiar, menaxheriale dhe operacional është i saktë, i besueshëm dhe në kohë;

- Aktivitetet dhe veprimet janë në pajtueshmëri me politikat, standardet, procedurat dhe ligjet e rregulloret e zbatueshme;
- Burimet sigurohen me ekonomicitet, përdoren me efikasitet dhe mbrohen në mënyrë adekuate;
- Programet, planet dhe objektivat janë përmbushur;
- Cilësia dhe përmirësimi i vazhdueshëm janë integruar në procesin e kontrollit të brendshëm;
- Çështjet e rëndësishme legislative ose rregullatore që kanë ndikim të puna e NJAB janë të njohura, trajtohen dhe adresohen siç duhet.

5. QËLLIMI

Çdo njësi e auditimit të brendshëm duhet të ketë një Statut i cili përcakton statusin organizativ të Njesisë së Auditimit të Brendshëm duke përkufizuar qëllimin, autoritetin dhe përgjegjësinë e saj.

Standarti Atributiv 1000- **Qëllimi, Autoriteti dhe Përgjegjësia** i IIA, përcakton shprehimisht:

Qëllimi, autoriteti dhe përgjegjësia e aktivitetit të auditimit të brendshëm duhet të përcaktohet formalisht në Statutin e Auditimit të Brendshëm, në përputhje me Përkufizimin e Auditimit të Brendshëm, Kodit të Etikës dhe Standardeve. Drejtuesi/ja i Auditimit të Brendshëm duhet të rishikojë periodikisht statusin e auditimit të brendshëm dhe ta paraqesë atë për miratim të menaxhimit i lartë dhe bordi.

Statuti i miratuar nuk është një dokument i “mbyllur/përfunduar”. Ai duhet të azhurnohet kur ndryshimet e brendshme ose të jashtme kanë ndikim në funksionin e auditimit të brendshëm. Azhurnimet e nevojshme duhet të iniciohen nga Drejtuesi i NJAB-së.

Qëllimi kryesor i auditimit të brendshëm është të ndihmojë dhe ti japë mbështetje Kryetarit të bashkise për të përmbushur me efektivitet përgjegjësitë e veta, duke përdorur një metode sistematike dhe të disiplinuar, duke i raportuar mbi vlerësimin në mënyrë të pavarur për përshtatshmërinë dhe efektivitetin e proceseve të administrimit të rrezikut e proceseve të kontrollit dhe proceseve të qeverisjes.

Auditimi i brendshëm duhet të asistojë të gjitha nivelet e menaxhimit në kryerjen efektive të përgjegjësiave të tyre me anë të analizave të pavarura, vlerësimeve, këshillimeve e rekomandimeve lidhur me veprimet e ekzaminuara.

Veprimtaria e Auditimit të Brendshëm ka për qëllim :

- Të ndihmojë subjektet e bashkise për të qenë të përgjegjshëm ndaj publikut, duke vlerësuar zbatimin e ligjit, rregulloreve dhe kontrolleve të vendosura, si dhe duke siguruar dobinë, frytshmërinë dhe kursimin e veprimeve;
- Të japë siguri objektive tek organet mbikëqyrëse/titullarët, mbi saktësinë dhe besueshmërinë e raporteve financiare dhe raporteve të performancës, të përgatitura nga strukturat e menaxhimit;

- Të ndihmojë menaxhimin e sektorit publik në arritjen e qëllimeve dhe objektivave të tyre, duke përmirësuar sistemet dhe shërbimet e bashkisë dhe duke përdorur me efektivitet burimet,
- Të minimizojë mundësitë për mashtrim, shpërdorim dhe abuzim; dhe
- Të ndihmojë punonjësit në përmirësimin e performancës së përgjithshme të punës dhe në zbatimin e kontrolleve të vendosura.

6. OBJEKTI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Objekti i veprimtarisë së auditimit të brendshëm :

A. Është kryerja e auditimit të brendshëm në të gjitha subjektet e sistemit të Bashkisë, për të gjitha strukturat, programet, veprimtaritë dhe proceset, përfshirë dhe fondet e Bashkimit Evropian .

B. Përfshin shqyrtimin dhe vlerësimin e aktiviteteve, operacioneve, proceseve, procedurave dhe sistemeve në bashki si njësit e sektorit publik, për të siguruar :

- a) Besueshmëri dhe integritet të informacionit financiar dhe operacional;
- b) Pajtueshmëri me politikat, planet, procedurat, ligjet dhe rregullat;
- c) Ruajtje të aktiveve;
- d) Përdorimin me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet të burimeve;
- e) Përbushje të objektivave dhe qëllimeve të vendosura në lidhje me veprimtaritë ose programet e bashkisë si njësi publike;

7. PËRGJEGJSHMËRIA

Drejtuesi i Auditimit të brendshëm, në përbushjen e detyrave të veta përgjigjet përpara menaxhimit që :

- Të japë vlerësime vjetore mbi përshtatshmërinë dhe efektivitetin e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të riskut në sistemin e bashkisë përfshirë të gjitha njësitë e varësisë;
- Të raportojë rregullisht për dobësitë kryesore të identifikuara nga auditimi, së bashku me rekomandime për përmirësimin e mjedisit të kontrollit të brendshëm.
- Të informojë periodikisht drejtuesit e lartë mbi gjendjen dhe rezultatet e planit vjetor të auditimit dhe mjaftueshmërinë e burimeve të Njesisë së AB;
- Të koordinojë dhe mbikëqyrë funksionet e tjera të kontrollit dhe ato monitoruese (menaxhimin e riskut, përputhshmërinë, sigurinë, ligjshmërinë, etikën, mjedisin, auditimin e jashtëm).
- Të raportojë për rezultatet e shërbimit këshillimor dhe konsulencës për menaxhimin e lartë, si një nga detyrat e tij të ngarkuara me ligj;

Drejtuesi i Auditimit të brendshëm:

- a) Paraqet tek Kryetari i bashkisë vlerësimet për përshtatshmërinë dhe efektivitetin e kontrollit të brendshëm, administrimit të rreziqeve dhe proceseve të qeverisjes;
- b) Paraqet tek Kryetari i bashkisë, gjetjet dhe rekomandimet në lidhje me angazhimet e kryera të auditimit;
- c) Përgatit Raportin Vjetor për ecurinë e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, përbushjen e planit të punës dhe zbatimin e rekomandimeve të auditimit;

8. PAVARËSIA DHE OBJEKTIVITETI

Standarti Atributiv 1100- **Pavarësia dhe Objektiviteti** i IIA, përcakton shprehimisht:

Aktiviteti i auditimit të brendshëm duhet të jetë i pavarur dhe audituesit e brendshëm duhet të jenë objektiv në përmbushjen e detyrave të tyre.

Veprimtaria e auditimit të brendshëm është e pavarur nga pikëpamja **funksionale dhe organizative**.

Funksioni i auditimit të brendshëm ka status të pavarur brenda bashkise në dhënien e opinioneve dhe rekomandimeve.

Pavarësia Funksionale, nënkupton që veprimtaria e auditimit të brendshëm (struktura e AB/ Audituesit) duhet :

- Të kryejnë misionin e tij në mënyrë të pavarur që në planifikimin, kryerjen dhe raportimin e rezultateve dhe rekomandimeve të auditimit nga subjekti që auditohet. Kryerja e auditimit duhet të zhvillohet sipas kuadrit ligjor e rregullator, standardeve dhe metodologjisë së auditimit të brendshëm dhe nuk i nënshtrohet asnjë ndikimi tjetër nga individë me autoritet, qofshin këta brenda apo jashtë bashkisë.
- Të ushtrojnë në mënyrë të pavarur funksionin e auditimit, pa lënë hapësirë për ndërhyrje nga kolegët, mbikqyrësit, drejtuesit e njësisë së auditimit apo pala e audituar, me përjashtim të marrëdhënieve të ndërsjellta të këshillimit.
- Të japin gjykime të paaneshme dhe të drejtëpërdrejta që janë me rëndësi thelbësore për zhvillimin e duhur të angazhimeve të auditimit të brendshëm. Të jenë funksionalisht përgjegjës mbi baza të përherëshme.
- Të mos ketë detyra, kompetenca, autoritet, funksione dhe përgjegjësi të tjera përveç atyre që lidhen me menaxhimin e funksionit të auditimit të brendshëm.
- Të mos jetë e lidhur me zbatimin, zhvillimin apo implementimin e detajuar të sistemeve të reja por mund të japin këshillime para dhe pas zhvillimeve të tilla.

Pavarësia Organizative, nënkupton që veprimtaria e auditimit të brendshëm / Audituesit duhet :

- Të raportojnë te Drejtuesi i DAB dhe nëpërmjet Tij, raportohet drejtëpërdrejtë tek drejtuesi i njësisë që auditohet, si niveli më i lartë i drejtimit në njësinë që auditohet dhe direkt tek Kryetari i Bashkise.
- Të jenë të lirë nga ndërhyrjet në përcaktimin e objektit të auditimit, kryerjen e misionit dhe komunikimin e rezultateve,
- Të mos angazhohen dhe të mos përfshihen në kryerjen e funksioneve dhe veprimtarive të tjera brenda bashkisë të cilat nuk lidhen me funksionimin e Auditimit të Brendshëm.
- NjAB është pjesë e strukturave të menaxhimit dhe jo e strukturave operacionale të Bashkisë Vlorë
- Të mbajnë qëndrim të paanshëm, qëndrim jo-tendecioz dhe të shmangin konfliktin e interesit.

9. PËRGJEGJËSITË E AKTORËVE

9.1 Kryetari i Bashkisë është përgjegjës për:

Sigurimin e shërbimit të auditimit të brendshëm, të kompletuar me kapacitetet profesionale e me burime të përshtatshme, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi,
 Miratimin e Kartës së Auditimit të Brendshëm;
 Miratimin e Planit Strategjik dhe atij Vjetor të auditimit, që ndjek Njesia e AB, ku adresohen të gjitha zonat e rëndësishme dhe ato të rrezikut të lartë;
 Shqyrtimin, vlerësimin dhe miratimin (me apo pa ndryshime të përfundimeve të misionëve të auditimit për çdo subject të audituar);
 Të autorizuar kryerjen e investigimeve dhe hetimeve të duara nga shërbimi i auditimit mbi strukturat e ekzekutivit, për ato raste që ka informacione dhe sinjalizime për veprime apo veprime nga ana e zyrtarëve, me pasojë dëmtimin e interesave të shtetit.

9.2 Drejtuesi i Njesisë së Auditimit të brendshëm, është përgjegjës për të siguruar:

- Organizimin e angazhimeve të auditimit të brendshëm, sipas standardeve dhe metodologjisë së miratuar në përputhje me kërkesat e ligjit bazë të organizimit të këtij profesioni;
- Hartimin e Kartës së Auditimit, akteve të tjera specifike për fusha të veçanta të auditimit të brendshëm, si dhe dergimin e tyre për administrim në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm pas miratimit nga Kryetari i bashkisë;
- Hartimin dhe zbatimin e planit strategjik e vjetor të auditimit, të bazuar në metodologjinë e vlerësimit të riskut, duke përfshirë risqet e kontrollit të brendshëm të sygjera nga menaxhimi dhe përcaktuar prioritetet e funksionimit të auditimit të brendshëm si dhe dergimin e tyre për administrim në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm pas miratimit nga Kryetari i bashkisë;
- Zbatimin e planit vjetor të auditimit siç është miratuar përfshirë edhe ndonjë detyrë ose projekt të posaçëm të kërkuar nga menaxhimi/Kryetari i Bashkisë;
- Përgatitjen e raporteve vjetore dhe periodike tek drejtuesit e lartë/ Kryetari i Bashkisë, të cilat të përmbajnë të dhënat lidhur me:
 - ✓ Angazhimet dhe objektivat e auditimit të kryer gjatë periudhës së raportuar, kohëzgjatjen e çdo auditimi dhe nëse ka patur shmangie nga plani jepen arsytet dhe argumentat përkates;
 - ✓ Konkluzionet dhe përfundimet lidhur me vlerësimin e funksionimit të sistemeve të kontrollit brenda njësisë publike, së bashku me rekomandimet për përmirësim;
 - ✓ Veprimet e ndërmarra nga menaxhimi për zbatimin e rekomandimeve, si dhe çdo rekomandim të pazbatuar.
- Përgatitjen e raportit vjetor të veprimtarisë së AB ku komunikohen rezultatet e angazhimeve të auditimit dhe përcjella e tij në Ministrinë e Financave/tek Struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm
- Sigurimin e cilësisë së angazhimeve të auditimit dhe përpilimin dhe mirëmbajtjen e programit të sigurisë së cilësisë për vlerësimin e veprimeve të NjAB-së.

- Ndjek veprimet e ndërmarra nga kryetari i bashkise për zbatimin e rekomandimeve, si dhe çdo rekomandim të pazbatuar;
- Mbajtje të stafit auditues me nivel profesional dhe me njohuri të mjaftueshme, aftësi, përvojë dhe çertifikime profesionale si dhe duke ndjekur zbatimin e grafikut të trajnimit të vijueshëm profesional të punonjësve të drejtorisë;
- Kryerje të shërbimeve të konsulences, përtej shërbimeve të Auditimit të Brendshëm për dhënien e sigurisë, të asistojë drejtuesit/menaxhimin në arritjen e objektivave;
- Të identifikojë e vlerësojë proceset dhe operacionet e kontrollit të brendshëm që janë të reja ose në zhvillim e sipër (dhe / ose zgjerimin e tyre) që lidhen me zhvillimin, implementimin ose zgjerimin e tyre;
- Raportimin menjëherë në formë të shkruar tek Kryetari i Bashkise dhe te Ministri i Financave, i cili ka në varësi strukturën e inspektimit financiar publik, kur zbulon parregullsi apo veprime, që në vlerësimin e njësisë së auditimit përbëjnë vepër penale.
- Koordinimin e përpjekjeve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm për të siguruar përfshirjen adekuate të auditimit dhe pakësimin e dyfishimit të përpjekjeve të auditimit;

9.3 Auditët janë përgjegjës për:

- Të njohin, të respektojnë dhe të ushtrojnë veprimtarinë audituese në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe me standardet ndërkombëtare, të pranuar, të auditimit të brendshëm;
- Të ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë objektive dhe me profesionalizëm;
- Të veprojnë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Kodin e Etikës, Kartën e Auditimit dhe rregullat për konfidencialitetin për audituesin e brendshëm;
- Të kryejnë auditime në mënyrë të pavarur, nga pikëpamja profesionale, duke u udhëhequr nga interesi publik, për të forcuar besimin në ndershmërinë, paanësinë dhe efektivitetin e shërbimit;
- Të ruajë konfidencialitetin e të dhënave, fakteve apo rasteve të gjetura gjatë kryerjes së auditimit;
- Të përditësojnë rregullisht njohuritë dhe aftësitë e tyre profesionale, në mënyrë që t'i përdorin ato me efikasitet dhe për të garantuar cilësinë e shërbimit.
- T'i japin rekomandime për strukturën/njësinë e audituar për përmirësimin e veprimtarisë, efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe për masat që duhen ndërmarrë në rastet e konstatimit të dëmeve ekonomike e financiare për zhdëmtimin e tyre dhe për të ulur mundësinë e përsëritje;
- Të raportojë menjëherë tek drejtuesi i njësisë së auditimit kur zbulohen parregullsi apo veprime, që në vlerësimin e auditimit të brendshëm përbëjnë vepër penale.

10. AUTORITETI

Drejtuesi i NjAB dhe stafi i Auditimit të Brendshëm janë të autorizuar:

- Të ushtrojnë në mënyrë të pavarur dhe me objektivitet funksionin e AB, ndaj aktiviteteve që marrin në shqyrtim, pa lënë hapësirë për ndërhyrje nga koleget, mbikëqyrësit, drejtuesit e njësisë së auditimit apo pala e audituar, me përjashtim të marrëdhënieve të ndërsjellta të këshillimit;

- Të ketë të drejta hyrjeje dhe përdorimit të plotë dhe të pakufizuar tek të gjitha veprimtaritë, informacionet dhe punonjësit e strukture/njësise se audituar;
- Të kenë akses të plotë, të lirë dhe të pakufizuar mbi të gjitha bazat e të dhënave me karakter teknik, ekonomik e financiar dhe të drejtimit për njësinë që auditohet, duke e konsideruar të nevojshëm për ti mundësuar këtij shërbimi të përmbushë përgjegjësitë e veta;
- Te marrin nga punonjësit e njësise së audituar, për rastet që gjykohet e nevojshme, shpjegime, deklarata, informacione me shkrim dhe fotokopje te dokumenteve (në të cilat drejtuesi i njësise së audituar ka vënë shënimin “e njëjtë me origjinalin”) që kanë lidhje me kryerjen në mënyrë te pavarur dhe me objektivitet të funksionit të auditimit të brendshëm;
- Të gjitha të dhënat, dokumentacioni dhe informacioni që arrihet gjatë kryerjes së aktiviteteve të auditimit do të përdoret vetëm për kryerjen e ketyre aktiviteteve. Drejtuesi i AB, përgjegjësit e grupeve të angazhimit dhe çdo anëtar individual i stafit të auditimit të brendshëm janë përgjegjës dhe të përgjegjshëm për ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit që marrin gjatë procesit së punës së tyre.
- T'i paraqesë kërkesën drejtuesit te njësise së auditimit për heqjen dorë nga një veprimtari auditimit, kur çmojnë se për shkaqe të argumentuara cenohen besueshmëria dhe cilësia e auditimit;
- T'i ofrohet asistenca dhe bashkëpunimi i nevojshëm nga personeli i njësise që auditohet gjatë zhvillimit të veprimtarisë së auditimit, si dhe shërbime të tjera të specializuara nga brenda ose jashtë njësise që auditohet;

11. INTEGRITETI

Njësia e auditimit të brendshëm dhe çdo auditues i brendshëm do të kryejë auditime të brendshme në mënyrë të përpiktë profesionale në pajtueshmëri me të gjitha kërkesat ligjore, duke shmangur të gjitha konfliktet e interesave dhe duke mos lejuar që konsideratat personale të çfarëdo përshkrimi të ndikojnë apo influencojnë mënyrën se si ata e kryejnë auditimin e brendshëm.

Integriteti i audituesëve të brendshëm krijon besimin dhe për rrjedhojë siguron bazat e besimit në gjykimet e tyre.

Audituesi i brendshëm në veprimtarinë e tij zbaton kodin e etikës dhe:

- siguron paanshmëri dhe pavarësi, vepron pa konflikt interesi, si në fakt dhe në dukje;
- përmbush përgjegjësitë e veta duke ushtruar kujdesin e duhur profesional dhe kompetencë në përputhje me standardet e profesionit;
- përpiqet për të përmbushur aftësitë dhe cilësitë e shërbimit nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm profesional dhe përvojës;
- ndërmerr ato lloj përgjegjësish që përputhen me aftësitë dhe me rolin profesional;

12. KUFIZIMET

Drejtuesi dhe personeli i Njësise të Auditimit të Brendshëm në përmbushjen e përgjegjësiave të veta, nuk autorizohen:

- ✓ Të kryejnë asnjë detyrë operationale brenda dhe për Bashkinë;
- ✓ Të kryejnë ose të drejtojnë drejtpërdrejt ndonjë veprim ose operacion të cilin e auditojnë;
- ✓ Të hartojnë dhe të vendosin procedura, të nxjerrin urdhëra e udhëzime, të përgatisin dokumente dhe informacione për veprimtari që auditohen;
- ✓ Të vijë në ndihmë të punonjësve të tjerë për përgjegjësitë që iu janë caktuar atyre;
- ✓ të auditojnë veprime ose operatione, për të cilat kanë qënë të punësuar dhe përgjegjës ne 3 vitet e fundit në njësinë që auditohet;
- ✓ të mbajnë një mandat politik apo të jenë të zgjedhur në funksionet drejtuese në strukturat e partive politike;
- ✓ Të ushtrojnë çdo veprimtari ose punë tjetër me pagesë apo të kenë perfitime të tjera të natyrave dhe formave, që i bëjnë të jenë konflikt interesash me ushtrimin e auditimit;
- ✓ Të krijojnë ose të miratojnë transaksione të llogarisë që janë jashtë njesisë së AB.
- ✓ Të drejtojnë veprimtaritë e punonjësve që nuk janë punësuar nga njesia e AB , përveçse kur këta punonjës janë caktuar në grupet e auditimit sipas nevojës ose në ndonjë mënyrë tjetër, për të ndihmuar audituesit e brendshëm.

Audituesit e brendshëm duhet t'i njohin kërkesat e **Nenit 18** të Ligjit mbi Auditimin e Brendshëm - **Konflikti i Interesave**, dhe t'u përmbahen atyre me përpikëri.

13.SHËRBIMET E SIGURISË DHE SHËRBIMET E KËSHILLIMIT (KONSULENCËS)

Llojet e shërbimeve të auditimit të brendshëm janë shërbimet e sigurisë dhe shërbimet e këshillimit, si më poshtë :

1.Një angazhim auditimi për **shërbimet e sigurisë** përfshin një vlerësin të pavarur të qeverisjes, menaxhimit të riskut dhe proceseve të kontrollit të bashkisë si njësi publike, nëpërmjet auditimit të përputhshmërisë, auditimit të performancës, auditimit financiar, auditimit të teknologjisë së informacionit dhe lloje të tjera të auditimit të brendshëm.

1.Auditimi i brendshëm ofron **shërbime këshilluese** për :

- a. çështje që lidhen me kontrollet e brendshme, hetimet speciale dhe fusha të tjera që paraqesin interes apo shqetësim, vetëm me kërkesë të Kryetarit të Bashkisë
- b. të ndihmuar në përmirësimin e qeverisjes, menaxhimit të riskut dhe proceseve të kontrollit të bashkisë.

2. Audituesi i brendshëm, mund të angazhohet në shërbime këshillimi për programe, projekte apo fusha të tjera që paraqesin interes ose shqetësim. Në të tilla angazhime nuk rrezikohet pavarësia e auditimit të brendshëm. Urdhëri i angazhimit të auditimit për shërbime këshillimi bëhet me nismën e Kryetarit të Bashkisë në të cilin përcaktohen me detaje, detyrat, përgjegjësitë dhe produktin e punës së auditimit të brendshëm

Një angazhim/detyrë auditimi **për shërbime këshillimi**, ka për qëllim të shtojë vlerën dhe të përmirësojë qeverisjen e njesisë publike, menaxhimin e riskut dhe proceset e kontrollit, pa qënë e nevojshme që audituesi i brendshëm të marrë përsipër përgjegjësi operationale.

14. STATUSI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË BASHKINË VLORE

Veprimtaria e auditimit të brendshëm në Bashkinë Vlorë

mbulon të gjitha programet dhe aktivitetet e bashkise së bashku me subjektet e varësisë;

- ✓ Përfshin shqyrtimin e të gjitha politikave dhe veprimeve financiare dhe jo- financiare (teknike, procedurale, administrative, etj);
- ✓ Zhvillohet në mënyrë të planifikuar duke zgjedhur dhe planifikuar për auditim efektivitetin dhe vlerësimin e sistemeve e fushave me risk tek njësitë brenda Bashkise si dhe në subjektet në varësi të saj.

Veprimtaria audituese:

- ✓ Eshtë e strukturuar në bazë të ligjit ne fuqi “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”,
- ✓ Eshtë zhvilluar bazuar në Planin Vjetor të Auditimit;
- ✓ Eshtë zhvilluar bazuar në Programin e Angazhimit të Auditimit, të hartuar për çdo strukture apo te gjitha nivelet e bashkise (njesise publike) qe auditohen, me qëllim për të vlerësuar sistemin e kontrollit të brendshëm , menaxhimin me efektivitet të fondeve publike dhe performancën e struktures apo njësisë se vartesisë që auditohet.

Auditimi i Brendshem raporton drejtperdrejte tek Kryetari i Bashkise, nga i cili ka varësinë organizative dhe funksionale .

Objekti kryesor i NjAB eshte :

- Të ndihmojë Kryetarin e Bashkise, të përmbushë misionin dhe objektivat korente dhe strategjike, duke kontribuar me vlerësimin, disiplinimin dhe përmirësimin e efektivitetit të menaxhimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, të riskut dhe proceseve të menaxhimit dhe drejtimit;
- Mbështetja e menaxhimit të larte/drejtuesve te funksioneve bashkiake për përmbushjen e objektivave, duke i dhënë siguri objektive për të gjitha fushat e veprimtarive që mbulon bashkia;
- Ofrimi i shërbimeve të këshillimit për Kryetarin e bashkise, për ta ndihmuar atë në marrjen e vendimeve të duhura dhe me synim shtimin e vleres, nepermjet vleresimit te sistemeve te kontrollit te brendshem;
- Dhënia e opinionit të pavarur mbi veprimtaritë e audituara dhe vlerësimi nëse ato janë zhvilluar në përputhje dhe në pajtim me ligjin dhe rregullat në fuqi dhe nëse drejtimi ka ndërtuar një sistem eficient të kontrollit të brendshëm dhe të menaxhimit të rreziqeve që karakterizojnë bashkise si njësi publike.

Roli i auditimit të brendshëm është të identifikojë rrezikun e mundshëm në aktivitetet e bashkise si njesi publike¹ dhe të shqyrtojë e vlerësojë përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm;

Njësia e AB ka qasje të pakufizuar në të gjitha aktivitetet e ndërmarra brenda juridiksionit, për të shqyrtuar, vlerësuar dhe raportuar në lidhje me :

- a) Përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemeve të kontrollit financiar, operacional, menaxhimit dhe operimin e tyre në praktikë në lidhje me rreziqet e konstatuara;
- b) Shkallën e pajtueshmërisë me politikat, standardet, planet dhe procedurat;
- c) Shkallën e përputhshmërisë me ligjet, rregulloret dhe detyrimet që burojnë nga angazhimet e ndryshme, përfshirë edhe kërkesat e raportimit para organeve shtetërore kompetente e të specializuara;
- d) Shkallën në të cilën burimet janë përdorur ekonomikisht dhe në mënyrë efikase dhe efektive, zbulimin e mashtimeve apo parregullsive të tjera;
- e) Përshtatshmërinë, saktësinë, besueshmërinë dhe integritetin e informacioneve financiare dhe të tjera, si dhe mjetet e përdorura për të identifikuar, matur, klasifikuar dhe raportuar një informacion të tillë;
- f) Përshtatshmërinë dhe funksionimin e organizimit të strukturave të brendshme dhe të gjitha nivelet e bashkise (njësise publike) që auditohen, për kryerjen e përgjegjësisë të tyre dhe për të siguruar që shërbimet i ofrohen publikut në mënyrë ekonomike, efikase, efektive, transparente dhe të qëndrueshme;
- g) Promovimin dhe përhapjen e praktikave më të mira që janë identifikuar dhe që duhet të komunikohen gjërësisht, për veprimet e ndërmarra nga kryetari i bashkise për korrigjimin e dobësive të identifikuara nga auditimi i brendshëm.

15. PROGRAMI I SIGURIMIT DHE PËRMIRËSIMIT TË CILËSISË

Sigurimi i cilësisë së punës audituese, është veprimtaria që përdoret për të vlerësuar proceset që janë ndërmarrë me qëllim që të sigurohemi se të gjitha veprimtaritë dhe angazhimet e Auditimit, përmbushin Standardet e miratuara dhe janë të dobishme për bashkinë dhe strukturat e saj të audituara.

Sigurimi i Cilesise:

- ☐ është pjesë e procesit të auditimit që bën të mundur zbatimin e Standardeve,
- ☐ implementohet gjatë gjithë fazave që kalon një angazhim auditimi dhe bëhet për gjithë procesin e auditimit,
- ☐ zbatohet nga Nj/AB për të gjitha angazhimet e auditimit.
- ☐ duhet parë si një instrument për të ndihmuar dhe përmirësuar funksionimin e Nj/AB konform Standardeve.

Qëllimi i procesit të sigurimit të cilësisë së punës së auditimit të brendshëm është për të përshkruar e siguruar që veprimtaria e auditimit të brendshëm është planifikuar dhe realizuar në përputhje me:

- Standartet e Auditimit të Brendshëm sipas IIA, Standartin 1300-Programi i Siguridhënies dhe Përmirësimit të Cilësisë;
- Legjislacionit në fuqi në fushën e “Auditimit të Brendshëm”;
- Standartet Ndërkombëtare Për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm (SNPPAB)

Programi i siguridhënies dhe përmirësimit të cilësisë duhet të vlerësojë efikasitetin dhe efektivitetin e aktivitetit të auditimit të brendshëm dhe identifikojë mundësitë për përmirësim.

Përfitimet nga procesi i Sigurimi dhe Menaxhimit të Cilësisë janë:

- Certifikon zbatimin e Standarteve të AB dhe të legjislacionit në fuqi në të gjithë procesin e auditimit.
- Rrit besueshmërinë e rolit dhe misionit të AB tek Drejtuesit e strukturave operacionale dhe njesive të vartësisë të audituara dhe Kryetari i Bashkisë;
- Kryetari i Bashkisë dhe Drejtuesit e njësive të tjera publike si Ministria e Financave, KLSH, etj marrin siguri të arsyeshme që auditimet janë kryer në përputhje me Standardet dhe Metodologjinë e AB.

16. STANDARDET DHE KUADRI I PRAKTIKAVE PROFESIONALE TË AUDITIMIT.

Veprimtaria dhe funksionimi i auditimit të brendshëm në Bashkinë Vlorë zhvillohet në pajtim me ;

- Standardet Ndërkombëtare të shpallura nga Instituti i Audituesve të Brendshëm të SHBA-së “Për praktikat Profesionale të Auditimit të Brendshëm”.
- Rregullat dhe metodologjinë e auditimit (procedurat për planifikimin, kryerjen, raportimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të lëna nga auditimi) të përcaktuara në Manualin e Auditimit të Brendshëm.
- Kërkesat e Kodit të Etikës për Audituesit e Sektorit Publik, miratuar nga Ministri i Financave (Urdhri nr 86, datë 10.12.2015) dhe rregullave të sjelljes në administratën publike.

17. HYRJA NË FUQI E KARTËS SË AUDITIMIT.

17.1 Kjo Kartë do të shqyrtohet dhe rishikohet sa herë lind nevoja mbi bazë të propozimeve të Drejtuesit të njesisë së AB. Çdo ndryshim substancial do të miratohet zyrtarisht nga Kryetari i Bashkisë.

17.2 Kjo Kartë është në fuqi që nga data e miratimit të saj.

PËRGJEGJËSE

Lirika Gavanj